Në bazë të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 39 të Statutit të Komunës së Deçanit , duke u nisur nga shqetësimet e ngritura nga qytetarët për zhvillimet e fundit në Kosovë, sipas Deklaratës së hartuar nga Grupi punues i ngritur nga Asambleja Komunale e Deçanit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.13.11.2015, duke u mbështetur në autorizimet që i dha Asambleja ku si temë shqyrtimi ka pasë të vetmen pikë: Shqyrtimi i kërkesës së grupit të delegatëve dhe nxjerrja e Deklaratës kundër formimit të Bashkësisë së Komunave Serbe në Republikën e Kosovës dhe kundër marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.13.11.2015, nxjerrë këtë :

# DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës së Deçanit, kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tërheqjen e dy marrëveshjeve të fundit, asaj të formimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe ( Zajednica) dhe marrëveshjes për demarkacionin e kufirit Kosovë-Mal i Zi në formatin e tanishëm .
2. Marrëveshja për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe ( Zajednica) cenon rendin Kushtetues dhe shpreh themelimin e një etniteti juridik mbi bazën e ndarjes etnike.
3. Kuvendi i Komunës së Deçanit i bënë thirrje Qeverisë së Kosovës që të tërheq marrëveshjen e demarkacionit të kufirit Kosovë-Mal i Zi, ku cenohet territori i Republikës së Kosovës.
4. Kjo marrëveshje cenon interesat e shumë lokaliteteve të Komunës së Deçanit, ku tradicionalisht kanë shfrytëzuar këto Bjeshkë. Fshatrat të cilave iu cenohen këto interesa janë: Llukë e Eperme, Strellc, Lëbushë, Dubovikë, Prapaqan, Gllogjan,Irzniq,Carrabreg, Dranoc etj.
5. Kuvendi i Komunës duke i trajtuar shqetësimet e ngritura nga qytetarët kërkon tërheqjen e këtyre marrëveshjeve në këtë format dhe rekomandon që për çështjet e ngritura të formohen komisione me konsensus më të gjerë në mënyrë që këto marrëveshje të formësohen konform Kushtetutës dhe interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Me këtë Deklaratë do të njoftohen:Qeveria e Republikës së Kosovës, MAPL dhe Arhivi i Komunës.

Deçan,dt.13.11.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E DEÇANIT · Kuvendi Komunal · REPUBLIKA KOSOVA · OPSTINA DECANE · Skupština Opštine · REPUBLIC OF KOSOVA · DEÇANI MUNICIPALITY · ASSEMBLY

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANE - DEÇANI MUNICIPALITY

Nga: / Od: / From: KK- Deçan
Nr. Prot: / Br. Prot: / Prot. No.: 29954
Nr. i faqeve: / Br. Strana: / No. Pages: 01
Data: / Datum: / Date: 18-11-15
DEÇAN DEÇANE

Na temelju članka 44. Zakona o Lokalnoj Samoupravi 03 / L-040 i članka 39. Statuta Općine Dečani, s'obzirom na probleme koje su iznijeli građani o najnovijim zbivanjima na Kosovu, navodi se u Deklaraciji izradila Radne Skupštine utvrđuje Skupštine Opštine Dečani na izvanrednoj sjednici održanoj dt.13.11.2015, oslanjajući se na ovlaštenje koje dala Skupštini, kao temu za razmatranje su imali samo jednu taćku: Razmatranje na zahtjev grupe poslanika i izdavanja Deklaracije protiv formiranja Zajednice Srpskih Općina na Kosovu i protiv sporazuma razgraničenja s Crnom Gorom, Općinski Skupština Dečani dt.13.11.2015, izvadila ovo:

# IZJAVA

1. Općina Dećane,tražila od Vladu Republike Kosovo, privlači obje nedavne ugovore, da je formiranje Udruženja srpskih većinski Općina (Zajednica) i sporazum o razgraničenju na Kosovu i Crnoj Gori u sadašnjom formatu.
2. Sporazum o formiranju Udruge srpskih Općina većinski (Zajednica) krši ustavni poredak i proglasio osnivanje pravne osobe na temelju etničke podjele.
3. Skupština Općina Dečani poziva Vladu Kosova povući sporazum o označavanju granice između Kosova i Crne Gore, koji je prekršio teritorij Republike Kosovo.
4. Ovaj sporazum krši interese mnogim mjestima u Opštini Dečani, gdje se tradicionalno koriste ove planine. Sela na koji su ti interesi pogođeni: Gornja Luka, Streoc, Lebush, Dubovik, Prapaqan Gllogjan, Irzniq, Carrabreg, Dranoc itd.
5. Skupština Općine koja tretira zabrinosti rješavanje pitanja postavljena od strane građana traži povlačenje tih sporazuma u ovom obliku i preporučuje da se pitanjima biti formirana komisija sa šireg konsenzusa kako bi se takvi sporazumi u obliku u skladu s Ustavom i interesa građana Republika Kosovo.

S' ovom Deklaracijom bit će objavljen: Vlada Republike Kosovo, MLS i Općinska arhiva.

Dećane, dt.13.11.2015

Skupštine Opštine Dećane
Predsjednik Skupštine
Jashar Dobraj

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČANE - DEÇAN MUNICIPALITY
Nga: / Od: / From: RK-Deç
Nr. Prot: 28954
Nr. i faqeve / Br. Stranica / No Pages: 01
Data / Datum / Date: 18.11.15
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E DEÇANIT - REPUBLIC OF KOSOVA - DECANI MUNICIPALITY